




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/14
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për pezullimin dhe largimin nga detyra të zyrtarëve publikë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

**KONCEPT DOKUMENTI PËR SUSPENDIMIN DHE LARGIMIN NGA
PUNA TË ZYRTARËVE PUBLIK**

Kapitulli 1: Hyrje

Koncept Dokumenti që ka të bëjë me pezullimin përkatësisht largimin nga detyra të zyrtarëve publik të akuzuar apo të dënuar për veprë penale të korrupsionit është pjesë e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2017, Pjesa e Ministrisë së Drejtësisë si dhe pjesë e Dialogut të Nivelit të Lartë Kosovë - BE për Prioritetet Kyçe, Agjenda për Reforma Evropiane - (ERA), e rrjedhimisht kjo është e ndërlidhur me Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, (*Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2017*), në të cilën ceket hartimi i Koncept dokumenti mbi ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar për korrupsion.

Kjo çështje është prioritet meqë përkon me objektivat e Qeverisë, sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, si njërin ndër prioritetet strategjike të Qeverisë për vitin 2017, si një nga sfidat më të mëdha për Kosovën është sektori i sundimit të ligjit me një numër çështjesh të përsëritura siç është pavarësia e gjyqësorit, korrupsioni etj.

Për prioritetet e menjëhershme dhe afatmesme në këtë fushë, Kosova duhet të fokusohet në:
1. Rishikimin dhe miratimin e legjislacionit duke e bërë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik, përkatësisht të akuzuarve dhe të dënuarve për korrupsion.

Po ashtu kjo çështje ndërlidhet edhe me kriteret, respektivisht indikatorëve të përcaktuar për Procesin e Reformës së Administratës Publike (RAP), e cila është caktuar parakusht dhe si zotim i institucioneve për marrjen e fondeve nga Bashkimi Evropian, proces ky në të cilin janë të përfshirë MIE, MAP, MD, KPK, KGJK, e të tjera.

Prandaj, Realizimi i veprimeve prioritare do të ndihmojë në zbatimin e MSA-së dhe në avancimin e Kosovës në rrugën e saj drejt integritimit evropian.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Aktualisht, nuk kemi një politikë të konsoliduar përkitazi me suspendimin e zyrtarëve publik të implikuar në vepra korruptive dhe keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtarë. Mos-ekzistimi i bazës ligjore konkrete shkakton një situatë të atillë ku zyrtarë publikë ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë apo të cilët janë dënuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtarë vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre publike edhe më tej. Kështu ushtrimi i funksionit nga këta zyrtarë konsiderohet jo legjitim nga ana e publikut dhe krijohet ndjenja e pasigurisë juridike. Një gjë e tillë ndikon në humbjen e besimit të publikut në institucione dhe në dekurajimin e raportimit të korrupsionit.

Janë identifikuar në praktikë edhe raste kur zyrtarë publikë të akuzuar apo edhe dënuar jo vetëm që vazhdojnë ushtrimin e detyrës por të njëjtit edhe avancohen në detyrë.

Problem në vete është edhe vazhdimi i ushtrimit të funksionit të zyrtarit publik pas marrjes së vendimit të plotfuqishëm me të cilin ky shpallet fajtor, fenomen ky i hasur jo rrallë në praktikë.

Politika aktuale

Kodi ynë Penal ka një kapitull të veçantë, i cili i kushton korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare (kapitulli XXXIV).

Megjithatë, sanksionimi i kryesve të veprave të inkriminuara në këtë kapitull të Kodit Penal parashihet vetëm pas plotfuqishmërisë së vendimit të gjykatës, me të cilin ata shpallen fajtor. Procedurat hetimore por edhe ato gjyqësore mund të prolongohen për një periudhë të gjatë duke bërë që të njëjtit zyrtarë që akuzohen për keqpërdorim detyre të vazhdojnë ushtrimin e funksioneve të tyre. Përkundër faktit që Kodi Penal i Republikës së Kosovës i ka kushtuar një rëndësi të veçantë veprave korruptive, nuk është paraparë një mekanizëm i cili do të mundësonte që në momentin e ngritjes së pretendimit ndaj një zyrtari publik për vepra korruptive të njëjtit t'i pamundësohet vazhdimi i ushtrimit të funksionit për të cilin është akuzuar se ka keqpërdorur.

Ligji për shërbyesit civil parasheh *“pezullimin parandalues” për nëpunësit civil kundër të cilëve është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve; të cilët mbahet në arrest në pritje të gjykimit; kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet* (Ligji Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 69, paragrafi 1). Në anën tjetër ky ligj parasheh kategoritë e punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil, dhe ndaj të cilëve nuk aplikohet statusi i nëpunësit civil (neni 4). Më konkretisht parashihet se *zyrtarët e zgjedhur në pozita zgjedhëse në institucionet e administratës publike dhe zyrtarët e emëruar nga zyrtarët e zgjedhur në pozita të caktuara (“funktionarët publikë”) nuk janë nëpunës civil (neni 4, paragrafi 2)*. Kështu Ligji për Shërbimin Civil nuk zbatohet për zyrtarët publikë dhe si i tillë as *“pezullimi parandalues”* i normuar në këtë ligj nuk vlej në për këtë kategori.

Ligji i Punës parasheh po ashtu *“largimin e përkohshëm nga puna” për të punësuarin ndaj të cilit ka filluar procedura penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale dhe ndaj të punësuarit që është në vuajtje të paraburgimit* (Ligji Nr. 03/L-212, i Punës, neni 73 paragrafi 1, nënparagrafi 1 dhe 2). Ky ligj vlen për të punësuarit dhe punëdhënësit në shërbimin publik dhe privat në Kosovë dhe si i tillë nuk përfshin edhe zyrtarët publik. Mirëpo duke marrë parasysh se instituti i suspendimit i normuar në këtë ligj si *“largim i përkohshëm nga puna”* parashihet edhe tek të punësuarit në shërbimin publik dhe privat, e siç u cek më lartë edhe tek nëpunësit civil, na del nevoja e madhe e normimit të suspendimit edhe për zyrtarët publik të cilët ushtrojnë funksione me peshë të madhe të cilat në rast keqpërdorimi mund të çojnë gjer në cenimin e rendit juridik të vendit.

Për të garantuar efikasitet dhe profesionalizëm në kryerjen e funksioneve publike është e rëndësishme të sigurohet që zyrtarët publik funksionet e tyre ti zbatojnë me ndërgjegje duke mos shfrytëzuar detyrën për dobi të veta apo me qëllim që personit tjetër t'i sjellin dobi apo t'i shkaktojnë dëm.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligji për shërbimin civil

Ligji Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në nenin 69 parasheh “pezullimin parandalues” për nëpunësit civil në rast të inicimit të procedurës penale ndaj tyre për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve; në rast arresti në pritje të gjyqimit; apo kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet (paragrafi 1). Mirëpo ky ligj taksativisht parasheh kategoritë e punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil dhe ndaj të cilëve nuk aplikohet statusi i nëpunësit civil. Përkitazi me këtë neni 4, paragrafi 2 parasheh se zyrtarët e zgjedhur në pozita zgjedhëse në institucionet e administratës publike dhe zyrtarët e emëruar nga zyrtarët e zgjedhur në pozita të caktuara (“funksionarët publikë”) nuk janë nëpunës civil. Pra rezulton se ndonëse pezullimi parandalues/suspendimi, parashihet si masë në Ligji për Shërbimin Civil i njëjti nuk vlen për zyrtarët publik të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil.

Kodi penal

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh veprat e korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare si: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar(neni 422); Keqpërdorimi i informatës zyrtare(neni 423); Konflikti i interesit (neni 424); Përvetësimi në detyrë(neni 425); Mashtrimi në detyrë (neni 426); Marrja e ryshfetit(neni 428); Ushtrimi i ndikimit(neni 431), e me radhë të listuara në kapitullin XXXIV të Kodit. Sanksionet e parapara për këto vepra penale siç dihet merren vetëm pas vendimit të plotfuqishëm nga gjykata dhe nuk parashihet masa e suspendimit nga momenti i ngritjes së aktakuzës ndaj personit zyrtar. Kodi Penal parasheh si dënime plotësuese Ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik(neni 65) dhe Ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës(neni 66)që kanë të bëjnë me sanksione që i shqiptohen personit zyrtar në rastin tonë nëse ka keqpërdorur detyrën. Këto dënime shqiptohen me vendim të plotfuqishëm të gjykatës dhe jo nga ngritja e aktakuzës ndaj personit zyrtar.

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale

Ky ligj në nenet 167 dhe 168 të tij parasheh ekzekutimin e dënimeve plotësuese të lartcekura të parapara me Kodin Penal (neni 65 dhe 66), ku parashihet që kur gjykata merr vendim që kryerësit t’ia caktoj dënimin plotësues, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon institucionit përgjegjës për ekzekutimin e këtij dënimi plotësues.

Shpenzimet aktuale

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: (shëno secilin lloj të shpenzimit)			
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)			
Financimi nga donatorët			
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave			

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Përvioja në shtetet tjera

Ekzistojnë praktika të ndryshme në shtetet e UE-së sa i përket asaj se si është e rregulluar ndërprerja e ushtrimit të funksionit nga zyrtarët publik si pasojë e akuzimit/dënimit për vepra korruptive apo keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Austria

Ndërprerja e punësimit në Austri përcaktohet me fuqinë e ligjit në rast të dënimit të plotfuqishëm si në vijim: (vepra e kryer me qëllim)

1. Dënimi për më shumë se një vit, në rast të dënimit me kusht;
2. Dënimi për më shumë se gjashtë muaj, pa kusht;
3. Dënimi apo një pjesë e dënimit ka të bëjë me veprat që lidhen me keqpërdorimin e pushtetit.

Belgjika

Në Belgjikë procedura për pushimin e zyrtarëve publik të dënuar konsiston si vijon:

Nëse dikush (duke përfshirë zyrtarët publikë) është dënuar nga një gjykatë penale me dënim nga 10 deri në 15 vjet burgim, gjykata ka detyrim të deklarojë se ky humbet të drejtën e tij qytetare për të qenë zyrtar publik.

Nëse dënimi është mes 5 dhe 10 vjet, gjykata penale mundet (jo detyrimisht) të merr vendim që i dënuari humb të drejtën për të qenë zyrtar publik për 10 apo 20 vjet.

Gjykatat jo penale dhe tribunalet (e instancës së 1) mund të urdhërojnë shkarkimin e zyrtarit publik, nëse kjo është paraparë në ligjin penal në lidhje me veprën e veçantë. Kjo është e paraparë edhe në rastet e korrupsionit / ryshfetit të zyrtarëve publikë.

Pra, në këto raste ai do të shkarkohet kur dënohet me vendim përfundimtar, pa procedura të mëtutjeshme (administrative).

Në praktikë, edhe në fazën e paraprake, prokurori do ta informojë hierarkinë e duhur të shërbimit publik, që një gjyqtar / prokuror po heton një vepër që përfshin një nga zyrtarët e tyre. Eprorët mund të iniciojnë procedurë disiplinore dhe të ndërmarrin masë të përkohshme (personi mund të pezullohet).

Bullgaria

Në Bullgari zgjidhja përkon me atë gjermane por ka disa variacione.

1. Në qoftë se një nëpunës civil ka qenë i dënuar për një vepër penale lidhur me detyrat e tij publike, ai është shkarkuar nga detyra. Ndalimi i personit të dënuar nga vazhdimi i ushtrimit të funksionit të tij është zakonisht dënim shtesë për një periudhë që nuk mund të kalojë kohëzgjatjen e dënimit kryesor (me burgim kryesisht) prej më shumë se 3 vjet. Zyrtar publikë ku të njëjtit i ndalohet puna mund të specifikohen në vendimin e gjykatës. Në një rast të tillë (siç ndodh zakonisht) zyrtari konsiderohet i shkarkuar nga dita që vendimi hyn në fuqi dhe nuk ka nevojë për veprime të tjera përkitazi me këtë. Megjithatë, në qoftë se, për disa arsye dënimi plotësues nuk shqiptohet, punëdhënësi është i autorizuar dhe i obliguar që menjëherë të ndërpresë kontratën e punës ndaj të punësuarit –duke u thirrur në faktin e papajtueshmërisë të statusit i 'dënuar' me kërkesat e zyrës. Duke qenë se mospërputhshmëria ndodh në momentin që vendimi gjyqësor është bërë i ekzekutueshëm, zyrtari publik nuk mund të ushtrojë detyrat e tij publike edhe nëse formalisht ende nuk është pushuar. Mund të zhvillohet kontest ligjor vetëm mbi kushtet e shkarkimit –lidhur me atë se a janë paguar si duhet pagat dhe përfitimet sociale, a ka ndonjë problem me procedurën e shkarkimit etj.

2. Nëse një nëpunës civil ka kryer një krim dhe ende nuk është dënuar, ai mund të ndalohet nga ushtrimi i detyrës si një masë brenda procedurës penale deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Në ndërkohë pavarësisht se kjo masë është marrë apo jo, institucioni mund të shkarkojë zyrtarin në fjalë bazuar në provat e mbledhura deri më tani (në qoftë se, për shembull, ato janë të mjaftueshme për të ardhur në konkluzionin e shkeljes disiplinore). Tani, ekzistojnë disa çështje të cilat mund të shkaktojnë konfuzion – ekziston mundësia që shkarkimi administrativ të bëhet i paligjshëm, nëse procedurat e detyrueshme për të nuk janë respektuar plotësisht. Në një rast të tillë mund të ketë një procedurë ankese para gjykatës së punës dhe gjykata do të vendosë në mënyrë të pavarur nga procedurat penale, në qoftë nëse ende është në procedim e sipër.

Kroacia dhe Holanda

Kroacia dhe Holanda përgjithësisht aplikojë më shumë se dy procedura përkitazi me heqjen nga funksioni të personave zyrtarë. Njëra është penale dhe tjetra është civile (kontestet e punës). Kështu për këtë çështje nuk ka automatikisht aplikim të vendimit penal dhe "e njëjta çështje do shqyrtohet gjyqësisht dy herë" që do të thotë një herë para gjykatës penale dhe më pas para gjykatës civile apo administrative.

Republika Çeke

Në legjislacionin e Republikës Çeke parashihet lirimi nga shërbimi si rezultat i ndjekjes penale apo caktimit të paraburgimit, si vijon:

(1) Një punonjës i shtetit do të lirohet nga kryerjen e detyrave të tij në bazë të një rezolute për fillimin e ndjekjes penale për një vepër të qëllimshme penale ose vepër penale kundër rendit publik të kryer nga pakujdesia deri në përfundim të ndjekjes penale. Një punonjës i shtetit do të lirohet nga kryerjen e detyrave të tij në rast se ai është ndaluar përgjatë kohës sa i njëjti mbahet në paraburgim. Lidhur me këtë organi i përfshirë në procedurat penale do të njoftojë menjëherë autoritetin e shërbimit civil.

(2) Që nga dita e lirit nga kryerja e shërbimit, punonjësi i shtetit do të kenë të drejtën për tu paguar në shumën prej 50% të pagës së tij mujore, por jo më pak se shuma e pagës minimale sipas një akt ligjor; kjo pjesë e pagës do të rritet me 10% për çdo vartës të punonjësit të shtetit, megjithatë, jo më shumë se deri në 80% të pagës së tij mujore. Vartësi nënkupton një person, të cilit punëmarrësi është i detyruar për ti siguruar jetesën. Shuma e reduktuar e pagës do të kthehet zyrtarit publik në rast pushimi të hetimeve apo mos shpalljes fajtor të tij me vendim të plotfuqishëm.

Disa profesione në Republikën Çeke kanë kushtet e tyre të papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit publik. Kështu për prokurorët publik parashihet me dispozita ndër të tjera se nuk kanë pajtueshmëri për ushtrimin e funksionit nëse ai / ajo është dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër dhe dënimi i tillë nuk ka paraparë ndalimin në ushtrimin e pozitës së prokurorit publik, nëse natyra e veprës penale për të cilin ai / ajo është dënuar e ven në dyshim kredibilitetin e tij për vazhdimin e ushtrimit të funksionit. Gjyqtarët kanë gjithashtu rregulla me dispozita të ngjashme.

Gjermania

Sistemi në Gjermani është mjaftë i ngjashëm me të Austrisë. Punësimi pushon në bazë të ligjit me dhënien e vendimit përfundimtarë nëse zyrtarit i shqiptohet dënimi 1 vit apo më shumë për vepër penale të kryer me dashje.

Francë

Një zyrtar publik mund të ndiqet penalisht në të njëjtën kohë dhe për të njëjtat fakte nga një organ disiplinor ose një gjykatë administrative, ndërsa ai ndiqet nga një gjykatë penale (për të gjitha llojet e shkeljeve kriminale natyrisht, dhe më konkretisht për korrupsion në kuadër të pozitës së tij publike). Të dy procedurat janë të pavarura nga njëra-tjetra.

Megjithatë, krahas sanksioneve penale 'klasike', gjykata penale mund ti shqiptoj zyrtarit publik 'sanksione plotësuese': papranueshmërinë ose ndalimin që të ushtroj një post publik. Këto ndëshkime çojnë automatikisht në shkarkimin e zyrtarit publik, dhe trupi disiplinor ose administrativ nuk do të ketë fjalë mbi të. Për më tepër, këto sanksione plotësuese janë të detyrueshme në rastet e korrupsionit, duke bërë që zyrtari publik të shkarkohet automatikisht. Ndalesa që të ushtroj një funksion publik mund të jetë e përkohshme ose e përhershme. Nëse sanksioni është i përkohshëm, funksionarët mund të kërkojnë ri-integrimin e tyre në institucionin publik.

Megjithatë, e njëjta çështje mund të rishikohet dy herë, vetëm në rast se gjykata penale nuk i ka shqiptuar një sanksion plotësues. Edhe pse këto sanksione janë të detyrueshme për veprën e korrupsionit, ato nuk vlejnë për shkelje të tjera penale. Në këtë rast, organi disiplinor ose gjyqtari administrativ mund të dënojnë personin me shkarkim nga funksioni.

Për shkak se të dy procedurat janë të pavarur nga një tjetër, organi disiplinor mund të shqiptojë shkarkimin edhe para se gjykata penale ta bëjë këtë. Por në praktikë, duket se shumicën e kohës, trupi disiplinor ose administrativ presin një vendim të gjykatës për të marrë masat e tyre nëse është e nevojshme. Gjatë ndjekjes, zyrtari publik në fjalë mund ose duhet të pezullohet nga funksionet e tyre.

Rumani

Ligji mbi statusin e nëpunësit civil në Rumani përcakton se nëse një zyrtar publik ka qenë i dënuar dhe ai ka një dënim plotësues që e ndalon të mbajë pozita publike, punësimi i tij pushon së ekzistuari. Për disa krime të rënda, ligji detyron në dënime plotësues. Për krimet e tjera gjyqtari mund të aplikojë një dënim plotësues nëse e konsideron të nevojshme.

Vendimi përfundimtar në Rumani është i mjaftueshëm për shkarkim. Po ashtu, për disa funksione publike të mos qenit i dënuar është kusht ligjor për punësim.

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Synimi i këtij koncept dokumenti është rritja e përpjekjeve për të dekurajuar dhe parandaluar në maksimum korrupsionin përmes suspendimit të zyrtarëve ndaj të cilëve ngritët aktakuza për korrupsion dhe keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtarë. Po ashtu synohet pamundësimi i dëmtimit të provave nga ana e zyrtarit publik të akuzuar si dhe ngritja e imazhit dhe besimit në institucione.

Objektivat

Specifike

- Krijimi i bazës ligjore;
- Rritja e efikasitetit dhe profesionalizmit, përgjegjshmërisë së zyrtarëve publik;
- Luftimi më efikas i korrupsionit

Pranueshme

Kjo çështje është prioritet meqë përkon me objektivat e Qeverisë, sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës.

Reale

Marrë parasysh rekomandimet e bëra nga raportet e ndryshme objektivi është i arritshëm.

Afatizuar

Objektivi mund të arrihet nga viti 2018.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Mos-krijimi i një bazë ligjore do të mundësonte vazhdimin e problemeve tashmë të identifikuara në këtë koncept dokument. Gjendja aktuale konsiderohet se është e pamjaftueshme dhe rrjedhimisht e pamundshme për luftimin me sukses të korrupsionit.

Vazhdimi i qasjes aktuale të ushtrimit të detyrës nga zyrtarët publikë të akuzuar dhe dënuar bën që efikasiteti, profesionalizmi dhe autoriteti i zyrtarëve publikë në institucionet shtetërore të vihet në pikëpyetje.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri

Gjendja ekzistuese mund të ndryshohet me miratimin e një Ligji të veçantë, me të cilin do të rregullohej suspendimi i zyrtarëve publik të akuzuar për korrupsion apo keqpërdorimi të pozitës apo autoritetit zyrtarë.

Qëllimi i kësaj politike për suspendimin e zyrtarëve publik është krijimi i një baze ligjore që do rregullonte qasjen ndaj zyrtarëve të cilët akuzohen për vepër korruptive apo keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtarë. Për më tej, qëllimi i këtij ligji konsiston edhe në forcimin e parimit të llogaridhënies, profesionalizmit dhe të meritës në këto institucione.

Opsioni 3: Plotësimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale

Situata aktuale e zbrazëtisë juridike sa i përket suspendimit të zyrtarëve publik mund të ndryshohet edhe me plotësimin/ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodin e Procedurës Penale duke integruar suspendimin si masë e përkohshme për personat zyrtarë në kuptim të Nenit 120 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në të cilin është definuar termi zyrtar publik.

Veprat për të cilat do të parashihen këto masa janë për vepra penale korruptive apo keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtarë, momenti apo koha e suspendimit do të merrej sipas legjislacionit përkatës në fuqi kur aktakuza bëhet e plotfuqishme.

Qëllimi i plotësim/ndryshimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale do të ishte që përmes suspendimit të këtyre zyrtarëve të parandalohet keqpërdorimi i mëtutjeshëm i autoritetit dhe njëkohësisht mos t'u lihet mundësia të ndikohet në prova, element ky kyç për të siguruar ndjekje penale të suksesshme.

Kjo masë e përkohshme që do përcaktohej me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale do të vlente për të gjithë personat zyrtarë të akuzuar për veprat e sipërpërmendura duke mundësuar kështu trajtim dhe qasje uniforme ndaj tyre pavarësisht nga funksioni apo detyra që ata mund të ushtrojnë.

Këto dispozita do t'u mundësonin gjykatave për të pezulluar përkohësisht zyrtarët publik nga pozita e tyre, në qoftë se ekziston mundësia që ata do të dënohen me një vendim të plotfuqishëm që shpie në largimin përfundimtar nga pozitat e tyre ose prania e këtyre zyrtarëve publik në vendin e punës do të mund të dëmtojë hetimet, prandaj, kjo dispozitë në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale do të mund të parashikonte pasojat e nevojshme ligjore mbi shkarkimin e zyrtarit publik.

Sipas këtij opsioni, propozimi është që këto dispozita të formulohen në këtë mënyrë, si në vijim:

Për Kodin Penal

Në nenin 65 një paragrafi i tretë do t'i shtohet, që ka të bëjë specifikisht me korrupsion:

3. Gjykata do t'i ndaloj një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike për një deri në 10 vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat që përfshihen në kapitullin XXXIV të këtij Kodi.

Në nenin 66 do të shtohet një paragraf, që ka të bëjë specifikisht me korrupsion:

3. Gjykata i ndalon një personi zyrtar ushtrimin e profesionit, aktiviteti të pavarur, të detyrës menaxhuese apo administrative prej një (1) deri në (10) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat në Kapitullin XXXIV të këtij Kodi.

Për Kodin e Procedurës Penale

'Neni 177a

Suspendimi i personit zyrtar nga detyra

1. Gjykata mund të suspendoj të pandehurin, i cili është një person zyrtar nga detyra e tij/saj, nëse;
 - 1.1 ekziston dyshim i bazuar që i pandehuri ka kryer veprë penale, dhe
 - 1.2 kushtet sipas Nenit 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2.2 apo 1.2.3 të Kodit janë përmbushur.
2. Gjykata vendos për masat sipas këtij Neni me aktvendim të arsyetuar. Aktvendimi duhet të përmbaj arsyetimin që përcakton se kushtet nga paragrafi 1 i këtij Neni janë përmbushur dhe është e nevojshme kjo masë.
3. Gjykata e përcakton në aktvendim që gjatë suspendimit, personi zyrtar nuk do të ketë qasje në objektet zyrtare të zyrës së tij/saj (vendit të punës), nuk do të ketë të drejtë të ndërmarr detyra zyrtare, dhe do të përmbahet prej kontaktimit të punësuarve në zyrën e tij/saj.
4. Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit dhe mbikqyrësit të tij/saj të drejtpërdrejt.
5. Gjykata i cakton paraburgim nëse i pandehuri nuk i përmbahet aktvendimit. I pandehuri duhet të jetë gjithmonë të informuar paraprakisht për pasojat e mos pajtueshmërisë.
6. Nëse mbikqyrësi i drejtpërdrejt i të pandehurit nuk merr veprime në ekzekutimin e aktvendimit mbi suspendimin, gjykata e dënon atë me gjobë siç përcaktohet në Nenin 444 të këtij Kodi.
7. Nëse diçka tjetër nuk parashihet në këtë Nen, dispozitat e këtij Kodi sa i përket paraburgimit do të zbatohen përshtatshëmrisht për caktimin, kohëzgjatjen dhe mbarimin e masës sipas këtij Neni.

8. Për kohëzgjatjen e masës sipas këtij neni para se të ngritet aktakuza vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës së prokurorit të shtetit.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Mos normimi i suspendimit të zyrtarëve publik të akuzuar për korrupsion dhe keqpërdorim detyre	Rregullimi i suspendimit të zyrtarëve publik përmes një ligji të veçantë	Plotësimi i Kodit Penal ku do integrohet normimi i suspendimit
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	/	MD, Gjykatat, Prokuroritë.	MD, Gjykatat, Prokuroritë.
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	/	Ligji i ri i veçantë	KPK dhe KPPK
Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni	/	/	/

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

1. Përfitimet e opsionit 1 (*status quo*).

Nuk ekzistojnë përfitime eminente në kuadër të vazhdimet të 'status quo'-së. Si përfitim mund të llogarisim faktin se nuk do ketë kosto të reja buxhetore si rrjedhojë e procedurës së krijimit të një baze ligjore për çështjen në fjalë.

2. Përfitimet e opsionit 2

- Krijimi i një baze të re ligjore lidhur me çështjen e suspendimit të zyrtarëve publik, që aktualisht nuk është e rregulluar në mënyrë të duhur

- Do rritej përgjegjshmëria, vetëdija, efikasiteti dhe profesionalizmi i zyrtarëve publik
- Do rritej intensiteti i luftimit të korrupsionit në qarqet e institucioneve shtetërore
- Është në përputhje me agjendën e përcaktuar për Reformë Evropiane – ERA

3. Përfitimet e opsionit 3.

- Përfitimet e opsionit 3 janë përafërsisht të ngjashme me ato të cekura në opsionin nr.2.
- Do mundësohej trajtimi i barabartë i të gjitha kategorive të personave zyrtar
- Kodi Penal është më lehtë i qasshëm
- Implementimi i dispozitave ligjore është shumë më i sigurt kur këto parashihen në Kod Penal sesa në akte tjera ligjore

Pasojat negative

1. Pasojat negative të opsionit 1 (*status quo*).

- Mund të rezultojë në keqpërdorim të mëtutjeshëm nga ana e zyrtarëve publik
- Mund të krijoj përceptimin e një politike mosndëshkuese duke nxitur akte të ngjashme nga të tjerë zyrtarë
- Do ndikonte në humbjen e besimit të publikut në institucione
- Do ndikonte në dekurajimin e qytetarëve për raportimin e korrupsionit
- Do krijonte trajtim jo të barabartë të kategoritë e ndryshme të personave zyrtarë duke marrë parasysh se suspendimi parashihet për disa kategori të personave zyrtarë kurse për disa të tjerë jo

2. Pasojat negative të opsionit 2 (hartimi i një ligji të veçantë).

- Nuk garanton luftim të plotë të korrupsionit
- Ka kosto të caktuar buxhetore

3. Pasojat negative të opsionit 3 (plotësimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale).

Pasojat negative të opsionit 3 janë përafërsisht të ngjashme me ato të cekura në opsionin 2.

Kosto

Në një Aneks të veçantë do të përfshihet një tabelë e hollësishme e ndikimit financiar të secilit opsion. Kjo tabelë do të përmbaj informatat relevante në formularin e Vlerësimit të Ndikimit Financiar.

Kapitulli 7: Konsultimi

Për rregullimin e fushës së lartpërmendur konsultimet kanë filluar më herët dhe si rezultat i konsultimeve ka dalë konkluzioni se është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me plotësimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale duke e integruar normimin e suspendimit të zyrtarëve publikë të akuzuar për vepra korruptive dhe keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Konsultimet do të bëhen konform Nenit 7 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë, deri më tani jemi konsultuar me ekspert të vendeve të ndryshme, të cilët kanë pasur pikëpamje të ndryshme, përfshirë këtu ekspertin gjerman Dr. Stefan Trunk Trunk, i cili ka ofruar dhe prezantuar një analizë para grupit punues, në të cilën ndër të tjera ka rekomanduar që korniza e brendshme ligjore duhet të plotësohet me një dispozitë, e cila u mundëson gjykatave për të pezulluar përkohësisht zyrtarët publikë nga pozita e tyre, në qoftë se ekziston mundësia që ata do të dënohen me një vendim të plotfuqishëm që shpie në largimin përfundimtar nga pozitat e tyre ose prania e këtyre zyrtarëve publik në vendin e punës do të mund të dëmtojë hetimet, po ashtu më tej eksperti rekomandon që të vendoset dhe zbatohet një dispozitë e re në Kodin Penal i cili parashikon pasojat e nevojshme ligjore mbi shkarkimin e zyrtarit publik.

Janë konsultuar edhe ministrinë përkatëse, përfaqësuesit e prokurorisë, gjyqësorit, që kanë qenë pjesë e grupit punues, organizatat e shoqërisë civile si dhe partnerët ndërkombëtar.

Gjatë takimeve të grupit punues ka pasur mjaft diskutime lidhur me çështjen se cili moment të konsiderohet pikënisje për aplikimin e suspendimit të përkohshëm, momenti i fillimit të hetimeve apo ai i ngritjes së aktakuzës, pas marrjes së komenteve të parashtruara nga anëtarët e grupi punues është konsideruar më e arsyeshme që ky moment të jetë koha e suspendimit sipas legjislacionit përkatës në fuqi kur aktakuza bëhet e plotfuqishme.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Opsioni i status quo-së nuk rekomandohet, kjo pasi mos-krijimi i një bazë ligjore nuk do mundësonte një luftim efikas të korrupsionit. Përveç kësaj, vazhdimi i kësaj politike do të dëmtonte edhe më tepër imazhin e institucioneve dhe për pasojë edhe rriste dekurajimin e qytetarëve në raportimin e këtyre veprave. Nga ana tjetër zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar do tu mundësohej të vazhdojnë me veprimtarinë e tyre të jashtëligjshme e për më tepër të njëjtë do vepronin të papenguar në fshehjen e provave.

Opsioni 2 (Hartimi i një ligji të veçantë) ka të ngjarë që të rris ndjeshëm efikasitetin në luftimin e korrupsionit duke u dhënë organeve të ndjekjes dhe atyre gjyqësore një instrument për luftimin e kësaj dukurie. Megjithatë, Ligji i veçantë konsiderohet se nuk ka fuqi të njëjtë impelmentuese në krahasim me Opsionin e 3-të (përfshirjen e suspendimit në Kodin Penal).

Opsioni 3 (Plotësimi i Kodit Penal) që ka të bëjë me integrimin e masës së suspendimit në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale që qon në arritjen e synimeve të parashtruara në këtë Koncept dokument. Kjo pasi që Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë ligje

bazike të një shteti dhe rrjedhimisht edhe shkalla e implementimit të këtyre dispozitave është shumë më e lartë. Do mundësohej trajtimi i barabartë i të gjitha kategorive të personave zyrtar të cilët akuzohen për vepra korruptive duke e përfshirë suspendimin si masë uniforme për të gjithë. Po ashtu duke qenë se në Kod normohen të gjitha veprat e korrupsionit dhe ato kundër detyrës zyrtare si dhe llojet e dënimeve kryesore dhe alternative për kryesit, shtimi i suspendimit si masë e përkohshme do mundësonte një rregullim kompakt të trajtimit të veprave në fjalë.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Opsioni 3 është opsioni i rekomanduar, përkatësisht plotësimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, rekomandimi është që Qeveria e Republikës së Kosovës të miratoj Koncept Dokumentin me qëllim që sa më parë të evitohen të metat ekzistuese si pasojë e mos ekzistimit të bazës ligjore. Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Drejtësisë në koordinim me institucionet përkatëse do të filloj procesin e plotësimit/ndryshimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, i cili është në fazën e plotësim/ndryshimit, duke shtuar dispozitat përkatëse për rregullimin e suspendimit dhe të njëjtat t'i dërgoj në Qeveri për procedim të mëtejshëm.

Kapitulli 10: Komunikimi

Ministria e Drejtësisë, në bashkëveprim me Ministrinë tjera të linjës, KPK, KGJK dhe institucionet tjera përkatëse do të jenë të përqendruara në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të plotësimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale për normimin e suspendimit, ku do të merren parasysh propozimet e akterëve të ndryshëm relevant, konsultimet me ekspertët në fushën e caktuar, si dhe konsultimi me shoqërinë civile.

Format e komunikimit do të jenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, grupet punuese dhe publikimet në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve tjera përkatëse, komunikimi do të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv.